



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

MBI

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. ERIN PJETER GJONI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK TË
BASHKISË LEZHË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA "SOCIAL DEMOKRATE"**

Sot më datë .05.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia "Social Demokrate" për Bashkinë Lezhë.

Baza ligjore: Nenet 5, 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

(1) Në zbatim të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

Data: 2023 Nr:
Ora:



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia "Social Demokrate" për Bashkinë Lezhë.

emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak”.

- (2) Me vendim të KQZ, z. Erin Pjeter Gjoni, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin e Bashkisë Lezhë, i mbështetur nga Partia “Social Demokrate”.

Për këtë kandidat në datën 28.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. Unik -LE-PSD-4943. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit elektronik ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Erin Pjeter Gjoni, ku konstatohet se kandidati në fjalë është i rehabilituar.

- (3) Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitet të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar gjenealitet të mëparshme.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “ 2 vite Shërbim prove Shkodër”, “Alba Itali 27.09.2011. Pezullim Burgimi”. “ Mal i Zi, Dhjetor 2017, Dënim me Gjobë 300 euro”
- Pyetjes 3 “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një veprë penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar: “Alba Itali 27.09.2011. Pezullim Burgimi”. “ Mal i Zi, Dhjetor 2017, Dënim me Gjobë 300 euro”
- Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar: “ I dyshuar për 186/1 dhe 291 të K.Penal periudha 2011, periudhë e përfshirë në masën e dënimit për të cilën citon nuk i kujtohen detajet”, “Alba Itali 27.09.2011. Pezullim Burgimi”. “ Mal i Zi, Dhjetor 2017, Dënim me Gjobë 300 euro”
- Pyetjes 8 “ A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “po” duke deklaruar se ka jetuar në Cuneo/Itali në periudhën 2011, për arsye emigracioni.

- (4) Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, KQZ çmon se është e

nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Social Demokrate” për Bashkinë Lezhë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr:
Ora:



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia “Social Demokrate” për Bashkinë Lezhë.